

K O N V E N T E

NDERMJET QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES SE ITALISE PER SHMANGJEN E TATIMEVE TE DYFISHTA LIDHUR ME TATIMET MBI TE ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN DHE PER PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Italisë,

Duke dëshiruar të përfundojnë një Konventë për shmangjen e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal,

Kanë rënë dakort për sa vijon:

NENI 1

FUSHEVEPRIMI I KONVENTES

Kjo Konventë do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose të të dy Shteteve Kontraktues.

NENI 2

TATIMET QE MBULON KONVENTA

1. Kjo Konventë do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin që zbatohen në emër të sejcilit Shtet Kontraktues ose një nënndarje të tij politike apo administrative ose autoritete lokale, pamvarësisht nga mënyra e vjeljes se tyre.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat total, mbi kapitalin në total ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë tatimet mbi fitimet nga shitblerja e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumat totale të pagave të paguara nga sipërmarrjet, si edhe tatimet mbi rivlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet egzistuese ndaj të cilave do të zbatohet kjo Konventë janë në veçanti:

(a) në rastin e Shqipërisë:

- (1) tatimi mbi të ardhurat personale,
- (2) tatimi mbi fitimin,
- (3) tatimet mbi biznesin e vogël,

edhe nëse ato janë tatime që vilen që në burim.

(në vijim do t'i referohemi si "Tatimet Shqiptare").

(b) në rastin e Italisë:

- (1) tatimi mbi të ardhurat e personave fizikë
(l'imposta sul reddito delle persone fisiche);
- (2) tatimi mbi të ardhurat e personave juridikë
(l'imposta sul reddito delle persone giuridiche);

edhe nëse ato janë tatime që vilen që në burim.

(në vijim do t'i referohemi si "tatimet Italiane").

4. Kjo konventë do të zbatohet gjithashtu për tatime të njëllojta ose tepër të ngjashme të cilat do të vendosen pas datës së nënshkrimit të kësaj Konvente si shtojcë ose në vend të tatimeve të referuara në paragrafin 3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do t'i bëjnë të ditur njëri tjetrit ndryshimet thelbësore që janë bërë në ligjet përkatëse tatimore.

NENI 3

PERCAKTIME TE PERGJITHSHME

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

(a) termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe përfshin gjithashtu çdo zonë tej ujrave territoriale të Shqipërisë, e cila ka qenë ose mund të jetë më vonë, bazuar në ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me Marrëveshjen midis Shqipërisë dhe Italisë për përcaktimin e kufijve të shelfit kontinental midis të dy vendeve, nënshkruar në Tiranë më 18 Dhjetor 1992, si një zonë brenda së cilës mund të ushtrohen të drejtat e Shqipërisë lidhur me tabanin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

(b) termi "Italia" nënkupton Republikën e Italisë dhe përfshin çdo zonë përtej ujrave territoriale të Italisë, e cila, në përputhje me ligjet e Italisë lidhur me zbulimin dhe shfrytëzimin

e burimeve natyrore dhe me Marrëveshjen midis Shqipërisë dhe Italisë për përcaktimin e kufijve të shelfit kontinental midis të dy vendeve, nënshkruar në Tiranë më 18 Dhjetor 1992, mund të konsiderohet si një zonë brenda së cilës mund të ushtrohen të drejtat e Italisë lidhur me tabanin detar, nëntokën dhe burimet natyrore;

(c) termat "një Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Shqipërinë ose Italinë siç e kërkon përmbajtja;

(d) termi "person" përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

(e) termi "shoqëri" nënkupton çdo organ korporativ ose çdo person ligjor që, në bazë të ligjeve të Shtetit Kontraktues nga ajo merr statusin si e tillë, trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

(f) termat "sipërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues" nënkuptojnë respektivisht një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

(g) termi "trafik ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije, avjon apo mjet të transportit rrugor që kryhet nga një sipërmarrje që ka vendin e saj të drejtimit efektiv në një Shtet Kontraktues, përveç kur anija, avjoni ose mjeti i transportit rrugor vepron vetëm midis vendeve të ndodhura në Shtetin tjetër Kontraktues;

(h) termi "nënështetas" nënkupton:

- (1) çdo individ që zotëron nënshtetësinë e një Shteti Kontraktues;
- (2) çdo person juridik, ortakëri ose shoqëri që gëzon statusin si e tillë në përputhje me ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues;

(i) termi "autoritet kompetent" nënkupton:

- (1) në rastin e Shqipërisë, Ministrin e Financave ose përfaqësuesin e autorizuar prej tij;
- (2) në rastin e Italisë, Ministrinë e Financave.

2. Përsa i përket zbatimit të kësaj Konvenete nga një Shtet Kontraktues, çdo term i pa përcaktuar këtu, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë sipas legjislacionit të atij Shteti Kontraktues lidhur me tatimet ndaj të cilave zbatohet Konventa.

NENI 4

REZIDENTI

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi "rezident i një Shteti Kontraktues" nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij Shteti, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme. Por ky term nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë Shtet lidhur vetëm me të ardhurat nga burime në atë Shtet apo kapitali i vendosur aty.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëhere statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

(a) ai do të konsiderohet rezident i Shtetit Kontraktues në të cilin ai ka një banesë të përherëshme në dispozicion të tij. Nëqoftëse ai ka një banesë të përherëshme në dispozicion të tij në të dy Shtetet Kontraktuese, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit Kontraktues me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike);

(b) nëqoftëse Shteti Kontraktues në të cilin ai ka qendrën e interesave jetike nuk mund të përcaktohet, ose nëqoftëse ai nuk ka një banesë të përherëshme në dispozicion të tij në asnjërin Shtet, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit Kontraktues në të cilin ai qëndron zakonisht;

(c) nëqoftëse ai qëndron rregullisht në të dy Shtetet Kontraktuese ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit Kontraktues nënshtetas i të cilit ai është;

(d) nëqoftëse ai është nënshtetas i të dy Shteteve Kontraktuese ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin këtë çështje me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person jo individ (pra për personat juridikë) është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëhere ai do të konsiderohet rezident i Shtetit Kontraktues në të cilin është vendosur qendra e tij e drejtimit efektiv.

NENI 5

SELI E PERHERESHME

1. Për qëllime të kësaj Konvente termi "seli (përfaqsi) e përherëshme" nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht aktiviteti i sipërmarrjes.

(Pra aktiviteti që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues).

2. Termi "seli e përhereshme" përfshin në veçanti:

- (a) një vend drejtimi;
- (b) një degë;
- (c) një zyrë;
- (d) një fabrikë;
- (e) një punishte;
- (f) një minierë, një pus nafte ose gazi ose çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore.
- (g) një shesh ndertimi apo montimi, ose projekt kompleks që zgjat më shumë se **dymbëdhjetë muaj**.

3. Termi "seli e përhereshme" nuk do të përfshijë:

- (a) përdorimin e paisjeve apo objekteve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose të shpërndarjes së mallrave që i përkasin sipërmarrjes;
- (b) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi apo shpërndarje;
- (c) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga një sipërmarrje tjetër;
- (d) mbajtja e një vendi fiks biznesi vetëm me qëllim blerjen e mallrave, ose për mbledhje informacioni, për sipërmarrjen;
- (e) mbajtja e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim reklame, për dhënje informacioni, për kërkime shkencore, ose për aktivitete të ngjashme që kanë karakter përgatitor ose ndihmës për sipërmarrjen.

4. Një person -i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur ndaj të cilit zbatohet paragrafi 5- që vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një sipërmarrje të Shtetit tjetër Kontraktues do të konsiderohet një seli e përhereshme në Shtetin e përmendur në fillim nëqoftëse:

- (a) ai ka, dhe zakonisht ushtron në atë Shtet, autoritetin të përfundojë kontrata në emër të sipërmarrjes, përveç kur aktivitetet e tij kufizohen në blerjen e mallrave për sipërmarrjen; ose
- (b) ai ka, dhe zakonisht ushtron në atë Shtet, një autoritet të përmbushë porosi në emër të sipërmarrjes nga një gjendje mallrash që mbahet në atë Shtet dhe që i përkasin sipërmarrjes.

5. Një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhereshme në Shtetin tjetër Kontraktues vetëm për faktin se ajo ushtron biznes në këtë Shtet tjetër nëpërmjet një ndërmjetesi, komisioneri të përgjithshëm

apo çdo lloj agjenti tjetër me një status të pavarur, kur të tillë persona veprojnë brenda kuadrit të zakonshëm të aktivitetit të tyre.

6. Fakti që një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, ose që ushtron aktivitet në atë Shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përherëshme ose në forma të tjera) nuk përbën në vetvete arësye të mjaftueshme për ta konsideruar njërën shoqëri seli të përherëshme të tjetrës.

NENI 6

PASURIA E PALUAJTSHME

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuria e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të taten në këtë Shtet tjetër.

2. Termi "pasuri e paluajtshme" do të përcaktohet në përputhje me ligjin e Shtetit Kontraktues ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së paluajtshme, inventarin e gjallë dhe paisjet e përdorura në bujqësi e në pyje, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjislacionit lidhur me pronësinë mbi tokën. Uzufrukti i pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël si shpërblim për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar vendburimet minerare, burime dhe rezerva të tjera natyrore, do të konsiderohen gjithashtu si "pasuri të paluajtshme". Anijet, varkat dhe avjonët nuk do të konsiderohen si pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira, ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një sipërmarrje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

NENI 7

FITIMET NGA BIZNESI I SIPERMARRJEVE

1. Fitimet e një sipërmarrje të një Shteti Kontraktues do të taten vetëm në atë Shtet përveç kur sipërmarrja ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përherëshme të vendosur aty. Nëqoftëse sipërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e sipërmarrjes

mund të tatonen në këtë Shtet tjetër por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet kësaj selije të përherëshme.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3, kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përherëshme të vendosur aty, atëhere në sejcilin Shtet Kontraktues selisë së përherëshme do t'i atribuohen fitimet që ajo do të realizonte sikur ajo të ishte një sipërmarrje e veçantë dhe e pavarur që do të vepronte në të njëjtin aktivitet ose në aktivitete të ngjashme, nën kondita të njëjta ose të ngjashme dhe tërësisht e pavarur nga sipërmarrja seli e përherëshme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përherëshme, do të lejohet reduktimi i shpenzimeve që janë kryer për qëllimet e selisë së përherëshme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive, si në Shtetin ku ndodhet selia e përherëshme ashtu edhe gjatë.

4. Përderisa në një Shtet Kontraktues, përcaktimi i fitimeve që do ti atribuohen një selie të përherëshme zakonisht bëhet në bazë të ndarjes së fitimeve totale të sipërmarrjes midis pjesëve të veçanta të saj, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojnë atë Shtet Kontraktues për përcaktimin e fitimeve që do të tatonen në bazë të një ndarje të tillë siç është bërë zakonisht. Megjithatë, metoda e ndarjes së fitimeve duhet të jetë e tillë që rezultati të jetë në përputhje me parimet që përmban ky Nen.

5. Asnjë fitim nuk do t'i atribuohet një selie të përherëshme vetëm për faktin se kjo seli e përherëshme blen mallra për sipërmarrjen.

6. Për qëllime të paragrafëve të mëparshëm, fitimet që i atribuohen një selie të përherëshme do të përcaktohen me të njëjtën metodë çdo vit përderisa nuk ka arsye të drejta dhe të mjaftueshme për të vepruar ndryshe.

7. Kur fitimet përmbajnë elemente të të ardhurave që trajtohen veças në Nene të tjera të kësaj Konvente, atëhere dispozitat e atyre Neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij Neni.

NENI 8

TRANSPORTI NDERKOMBETAR

1. Fitimet nga veprimtaria e anijeve, avjonëve apo mjeteve të transportit rrugor në trafikun ndërkombëtar do të tatonen vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet qendra e drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

2. Nëqoftëse vendi i drejtimit efektiv të një sipërmarrje të transportit detar është mbi bordin e një anije, atëhere ajo do të konsiderohet e vendosur në Shtetin Kontraktues ku ndodhet

porti ku qëndron anija, ose, në mungesë të një porti të tillë, në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është përdoruesi i anijes.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesëmarrja në një bashkësi, një biznes të përbashket apo në një agjensi ndërkombëtare transporti.

NENI 9

SIPERMARRJE TE LIDHURA

1. Kur:

- (a) një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin ose kapitalin e një sipërmarrje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose
- (b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo në kapitalin e një sipërmarrje të një Shteti Kontraktues dhe të një sipërmarrje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast kushtet që janë pranuar ose që janë diktuar midis dy sipërmarrjeve në mardhënjet e tyre tregtare apo financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që do të realizohej nga njëra sipërmarrje në mungesë të këtyre kushteve, por që për shkak të këtyre kushteve, nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj sipërmarrje dhe të tatóhet normalisht.

NENI 10

DIVIDENTET

1. Dividentet e paguar nga një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatóhen në këtë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, të tillë dividendë mund të tatóhen gjithashtu në Shtetin Kontraktues rezidente e të cilit është shoqëria paguese e dividendeve dhe në përputhje me ligjet e këtij Shteti, por nëse marrësi është pronari përfitues i dividendëve tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë 10 përqind të shumës bruto të dividendëve. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyren e zbatimit të këtij kufizimi.

Ky paragraf nuk do të ketë efekt mbi tatimin e shoqërisë lidhur me fitimet nga të cilat janë paguar dividendët.

3. Në funksion të këtij Neni, termi "dividentë" nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji, aksione të themelimit ose të drejta të tjera, që nuk janë kërkesa (tituj) borxhi, pjesmarrja në fitime, si edhe të ardhurat nga të drejta të tjera korporative që i nënështrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e Shtetit rezidente e të cilit është kompania që bën shpërndarjen e dividentëve.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividentëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues rezidente e të cilit është shoqëria pagueuse e dividentëve, nëpërmjet një selie të përherëshme të vendosur aty ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty dhe zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividentët është efektivisht i lidhur me këtë seli të përherëshme ose bazë fikse. Në një rast të tillë dividentët taten në atë Shtet tjetër Kontraktues në përputhje me legjislacionin e tij.

5. Kur një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ky Shtet tjetër mund të mos zbatojë tatim mbi dividentët e paguar nga shoqëria, përveç kur këto dividentë i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër ose kur zotërimi (pjesëmarrja) lidhur me të cilin janë paguar dividentët është efektivisht i lidhur me një seli të përherëshme ose bazë fikse të vendosur në këtë Shtet tjetër. Subjekt i tatimit mbi fitimet e pashpërndara nuk janë gjithashtu as fitimet e pashpërndara të kompanisë, edhe sikur dividentët e paguar ose fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht si fitime apo të ardhura të realizuara në këtë Shtet tjetër.

NENI 11

INTERESAT

1. Interesat që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në këtë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto interesa mund të taten edhe në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e atij Shteti, por kur marrësi është pronari përfitues i interesave tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 5 përqind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese me mirëkuptim reciprok do të vendosin mënyrën e aplikimit të këtij kufizimi.

3. Pamvarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesat e krijuara në një Shtet Kontraktues do të përjashtohen nga tatimi

në atë Shtet nëqoftëse:

- (a) paguesi i interesit është Qeverija e atij Shteti Kontraktues ose një autoritet lokal atje; ose
- (b) interesi paguhet nga Qeverija e Shtetit tjetër Kontraktues ose një autoritet lokal atje ose çdo agjensi apo institucion (përfshirë institucionet financiare) tërësisht të zotëruara nga ky Shtet tjetër Kontraktues apo autoritet lokal atje; ose
- (c) interesi i paguhet çdo agjensie tjetër ose institucioni (përfshirë institucionet financiare) lidhur me hua që janë dhënë në zbatim të marreveshjeve të përfunduara midis Qeverive të Shteteve Kontraktuese.

4. Termi "interesa" në kuptimin e përdorur në këtë Nen nënkupton të ardhurat nga titujt e borxheve shtetërore, nga obligacionet, të siguruara ose jo me hipotekim, dhe që e kanë ose jo të drejtën e pjesmarrjes në fitime, dhe kërkesat e borxhit të çdo lloji si dhe të ardhura të tjera të përfituara nga huadhënja, që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si interesat nga ligjet tatimore të Shtetit në të cilin realizohen të ardhurat.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëqoftëse përfituesi i interesave, duke qenë një rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen (lindin) interesat, nëpërmjet një selie të përherëshme të vendosur aty, ose kryen në këtë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe kërkesa e huasë lidhur me të cilën paguhet interesi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përherëshme ose bazë fikse. Në këtë rast interesat do të taten në këtë Shtet tjetër Kontraktues në përputhje me legjislacionin e tij.

6. Interesat do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është vetë ai Shtet, një nënndarje politike apo administrative, një autoritet lokal ose një rezident i atij Shteti. Megjithatë, kur personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përherëshme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur huaja për të cilën paguhet interesi, dhe këto interesa krijohen nga kjo seli e përherëshme ose bazë fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në Shtetin ku është vendosur selia e përherëshme ose baza fikse.

7. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe përfituesit të interesave ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesave, bazuar në huanë për të cilën paguhet, e kalon shumë mbi të cilën duhej të ishte rënë dakort midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të lidhjeve të tilla, dispozitat e këtij Nen do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e sejcilit

Shtet, duke patur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

NENI 12

TE ARDHURAT NGA E DREJTA E AUTORIT (HONORARET)

1. Të ardhurat nga e drejta e autorit (honoraret) që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në këtë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto të ardhura mund të taten gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij Shteti, por nëse marrësi është pronari përfitues i honorareve, tatimi i ngarkuar nuk duhet të kalojë 5 përqind të shumës bruto të honorarit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese me mirëkuptim reciprok do të vendosin mënyrën e aplikimit të këtij kufizimi.

3. Termi "honorare" në kuptimin e përdorur në këtë Nen nënkupton çdo të ardhur të marrë si pagesë për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte të autorit për punimet letrare, artistike ose shkencore, përfshirë filmat kinematografikë dhe filmat, kasetat e videokasetat për trasmetime radio-televizive, çdo patentë, markë tregtare, skice ose model, plan, proces ose formulë sekrete, ose për përdorimin apo të drejtën e përdorimit të paisjeve industriale, tregtare apo shkencore apo për informacione lidhur me eksperiencën industriale tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorareve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen honoraret nëpërmjet një selie të përherëshme të vendosur aty, ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe e drejta ose prona lidhur me të cilën paguhen honoraret është efektivisht e lidhur me këtë seli të përherëshme ose bazë fikse. Në këtë rast honoraret do të taten në këtë Shtet tjetër në përputhje me legjislacionin e tij.

5. Honoraret do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagues është vetë ai Shtet, një nënndarje politike apo administrative, një autoritet lokal ose një rezident i atij Shteti. Megjithatë, kur personi që paguan honoraret, qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përherëshme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur e drejta e pagimit të honorareve, dhe këto honorare kanë lindur nga kjo seli e përherëshme ose bazë fikse, atëherë këto honorare konsiderohen se kanë lindur në Shtetin Kontraktues ku është vendosur selija e përherëshme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis pagesit dhe perfituesit ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorareve, duke patur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakort midis pagesit dhe pronarit perfitues në mungesë të marrëdhënjëve të tilla, atëhere dispozitat e këtij Neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në një rast të tillë shuma e shpërblimit që kalon pagesën normale mbetet e tatueshme sipas ligjeve përkatëse të sejcilit Shtet Kontraktues, duke patur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

NENI 13

FITIMET NGA TJETËRSIMI I KAPITALIT

1. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në paragrafin 2 të Nenit 6, mund të taten në Shtetin Kontraktues në të cilin këto pasuri janë vendosur.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme që bëjnë pjesë në pasurinë e biznesit të një selie të përherëshme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuritë e luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i kësaj selie të përherëshme (vetëm ose bashkë me sipërmarrjen) ose i kësaj baze fikse, mund të taten në këtë Shtet tjetër. Fitimet e realizuara nga tjetërsimi i anijeve, avionëve ose mjeteve të transportit rrugor që veprojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve, avionëve apo mjeteve të transportit rrugor do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet qendra e drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

3. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohet nga paragrafët 1 dhe 2 do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është tjetërsuesi.

NENI 14

SHERBIMET PERSONALE TE PAVARURA

1. Të ardhurat e realizuara nga një individ që është rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me shërbimet profesionale ose aktivitete të tjera të një karakteri të pavarur do të taten vetëm në atë Shtet përveç në rrethanat që vijojnë, kur të tilla të ardhura mund të taten gjithashtu në Shtetin tjetër Kontraktues:

- (a) kur ai ka një bazë fikse në dispozicion të tij në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e aktiviteteve të tij; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet asaj baze fikse mund të tatóhet në Shtetin tjetër; ose
- (b) kur ai qëndron në Shtetin tjetër Kontraktues për një periudhë ose periudha që në total arrijnë ose kalojnë 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës; në këtë rast vetëm ajo pjesë e të ardhurave e realizuar nga aktivitetet e tij të kryera në atë Shtet tjetër mund të tatóhen në atë Shtet tjetër.

2. Termi "shërbime profesionale" përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore apo mësimdhënjeje si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinjereve, arkitekteve, dentistëve dhe llogaritarëve.

NENI 15

SHERBIMET PERSONALE TE VARURA

1. Pa cënuar dispozitat e Neneve 16, 18, 19, 20 dhe 21 pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga të qëniti i punësuar do të tatóhen vetëm në këtë Shtet përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në Shtetin tjetër Kontraktues, atëhere këto të ardhura të realizuara në këtë mënyrë mund të tatóhen në këtë Shtet tjetër.

2. Pamvarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet e përfituara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punën e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues do të tatóhen vetëm në Shtetin e përmendur në fillim nëqoftëse (plotësohen të tria kushtet që vijojnë):

- (a) përfituesi (marrësi) është prezent në Shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë 12 mujore që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës, dhe
- (b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i Shtetit tjetër, dhe
- (c) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përherëshme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në Shtetin tjetër.

3. Pamvarësisht nga dispozitat e mëparëshme të këtij Neni, shpërblimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anije, avioni ose mjeti të transportit rrugor që ushtron aktivitet në trafikun ndërkombëtar, mund të tatóhen në Shtetin Kontraktues në të cilin është vendosur vendi i drejtimit efektiv të

sipërmarrjes.

NENI 16

SHPERBLIMET E DREJTOREVE

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozitën e tij si anëtar i Keshillit të Drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërije që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, mund të taten në këtë Shtet tjetër.

NENI 17

ARTISTET DHE SPORTISTET

1. Pamvarësisht nga dispozitat e Neneve 14 dhe 15, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një artist theatri, kinematografie, radio-televizioni, muzikant apo sportist, nga aktivitetet e tij personale si i tillë, të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në këtë Shtet tjetër.

2. Të ardhurat e realizuara nga artistët ose sportistët që janë rezidentë të një Shteti Kontraktues do të përjashtohen nga tatimi në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin këto aktivitete ushtrohen nëqoftëse aktivitetet ushtrohen brenda kuadrit të një vizite që kryesisht mbështetet nga njëri apo të dy Shtetet Kontraktuese, ose nga nënndarje politike apo administrative, autoritete lokale apo institucione publike atje. Në një rast të tillë, të ardhurat taten vetëm në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është artisti ose sportisti.

3. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në pozitën e tij si i tillë realizohen jo direkt nga sportisti apo artisti por nga një person tjetër, këto të ardhura, pamvarësisht nga dispozitat e Neneve 7, 14 dhe 15, mund të taten në Shtetin Kontraktues në të cilin janë ushtruar aktivitetet e artistit apo sportistit.

NENI 18

PENSIONET

Pa cënuar dispozitat e paragrafit 2 të Nenit 19, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme paguar një rezidenti të një Shteti Kontraktues lidhur me punësimin e tij në të kaluarën do të taten vetëm në atë Shtet.

NENI 19

SHERBIMET QEVERTARE

1. (a) Shpërblimet, të ndryshme nga pensionet, e paguara nga një Shtet Kontraktues ose nga një nënndarje politike apo administrative ose një autoritet lokal atje një individ lidhur me shërbimet e kryera atij Shteti, nënndarje apo autoriteti do të taten vetëm në atë Shtet.

(b) Megjithatë, këto shpërblime do të taten vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse shërbimet janë kryer në atë Shtet dhe individ është rezident i atij Shteti, i cili:
 - (i) është nënështetas i atij Shteti, ose
 - (ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimit.
2. (a) Çdo pension i paguar nga, apo prej fondeve të krijuara, prej një Shteti Kontraktues ose një nënndarje politike apo administrative ose një autoritet lokal atje një individ lidhur me shërbimet e kryera atij Shteti ose nënndarje apo autoriteti do të taten vetëm në atë Shtet.

(b) Megjithatë, këto pensione do të taten vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse individ është nënështetas dhe rezident i atij Shteti.
3. Dispozitat e neneve 15, 16 dhe 18 do të zbatohen mbi shpërblimet dhe pensionet lidhur me shërbimet e kryera në lidhje me një aktivitet biznesi të ushtruar nga një Shtet Kontraktues ose një nënndarje politike apo administrative ose një autoritet lokal atje.

NENI 20

PETAGOGET, MESUESIT DHE KERKUESIT SHKENCORE

1. Shpërblimet që, një pedagog, mësues ose kërkues shkencor që është, ose ishte menjëherë para vajtjes në një Shtet Kontraktues rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është prezent në Shtetin e përmendur në fillim për një periudhë që nuk i kalon dy vjetët me qëllim kryerjen e studimeve apo kërkimeve shkencore apo për mësimdhënje në një universitet, kolegji, shkollë apo institucion tjetër arsimor, merr nga një punë e tillë nuk do të taten në atë Shtet, me kusht që të tilla shpërblime të jenë subjekt i tatimit në Shtetin tjetër Kontraktues.
2. Ky Nen nuk do të zbatohet ndaj të ardhurave nga kërkimet shkencore nëse të tilla kërkime ndërmerren kryesisht për përfitime private të një personi apo personave të veçantë.

NENI 21

STUDENTET, KURSANTET DHE SPECIALIZANTET

1. Pagesat që një student, specializant apo kursant që është ose ishte menjëherë para vajtjes në një Shtet Kontraktues një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është prezent në Shtetin e përmendur në fillim për një periudhë që nuk i kalon pesë vite vetëm për qëllim të arsimimit ose specializimit të tij, merr për të përballuar jetesën, arsimimin apo specializimin nuk do të tatohen në këtë Shtet, me kusht që këto pagesa kryhen nga burime jashtë këtij Shteti Kontraktues.

2. Të ardhurat e realizuara nga një student, një kursant apo specializant në lidhje me aktivitetet e ushtruara në një Shtet Kontraktues në të cilin ai ndodhet vetëm për qëllim arsimimi apo specializimi, nuk do të tatohen në atë Shtet, gjatë një periudhe të arsyeshme kohe për arsimimin apo specializimin, përveç kur këto të ardhura e kalojnë shumën e nevojshme për mbajtjen e tij, arsimimin apo specializimin.

NENI 22

TE ARDHURA TE TJERA

1. Lloje të të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që të krijohen, që nuk lidhen me artikujt e mëparshëm të kësaj Konvente do të tatohen vetëm në atë Shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, që nuk janë të ardhura nga pasuria e paluajtshme të përcaktuara në paragrafin 2 të Nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përherëshme të vendosur aty, ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose pasuria lidhur me të cilën paguhet shpërblimi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përherëshme ose bazë fikse. Në këtë rast këto lloje të të ardhurave janë të tatueshme në këtë Shtet tjetër Kontraktues në përputhje me legjislacionin e tij.

3. Kur, për shkak të lidhjeve të veçanta ndërmjet personave që ushtrojnë aktivitete nga të cilat realizohen lloje të të ardhurave që i referohen paragrafit 1, shpërblimet për këto aktivitete e kalojnë shumën që do të bihej dakort midis personave të pavarur, dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të tatohet në përputhje me legjislacionin e sejcilit Shtet Kontraktues, duke mbajtur në

konsideratë edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

NENI 23

KAPITALI

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme që i referohen paragrafit 2 të Nenit 6, të zotëruara nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatóhet në këtë Shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme që bëjnë pjesë në pasurinë e biznesit të një selie të përherëshme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura mund të tatóhet në këtë Shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anije, avionë ose mjete të transportit rrugor që veprojnë në trafikun ndërkombëtar dhe nga pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre anijeve, avjonëve dhe mjeteve të transportit rrugor, do të tatóhet vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

4. Të gjithë elementet e tjerë të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatóhen vetëm në këtë Shtet.

NENI 24

ELEMINIMI I TATIMIT TE DYFISHTE

1. Eshtë rënë dakort që tatimi i dyfishtë do të eleminohet në përputhje me paragrafët që vijojnë.

2. Në rastin e Shqipërisë:

Kur një rezident i Shqipërisë realizon të ardhura të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente mund të tatóhen në Itali, Shqipëria, do të lejojë një reduktim nga tatimi i saj mbi të ardhurat e këtij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Itali. Megjithatë, ky reduktim nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit Shqiptar mbi të ardhurat të llogaritur para dhënies së reduktimit që i atribuohet sipas rastit, të ardhurave që mund të tatóhen në Itali.

3. Në rastin e Italisë:

Nëqoftëse një rezident i Italisë realizon lloje të të ardhurave që janë të tatueshme në Shqipëri, Italia, në përcaktimin e tatimeve të saj mbi të ardhurat të specifikuar në Nenin 2 të

kësaj Konvente, mund të përfshijë në bazën mbi të cilën llogariten këto tatime llojet e të ardhurave të përmendura në fillim, përveç kur dispozita të veçanta të kësaj Konvente e përcaktojnë ndryshe.

Në një rast të tillë, Italia do të reduktojë nga tatimet e llogaritura në këtë mënyrë tatimin mbi të ardhurat të paguar në Shqipëri por në një shumë që nuk duhet të kalojë atë pjesë të tatimit Italian që i atribuohet llojeve të të ardhurave të përmendura në fillim për masën që ato të ardhura zënë në të ardhurat në total.

Megjithatë, për zëra të ardhurash që i nënështrohen në Itali një tatimi përfundimtar të mbajtur në burim, nuk do të jepen reduktime për kërkesat e përfituesve të këtyre të ardhurave, në përputhje me dispozitat e legjislacionit Italian.

4. Kur, në bazë të legjislacionit të njërit Shtet Kontraktues, çdo tatim mbi fitimet nga biznesi ndaj të cilave zbatohet kjo Konventë i cili (tatimi) është përjashtuar ose reduktuar për një periudhë të kufizuar kohe, për qëllimet e paragrafeve 2 dhe 3 të këtij Neni, një tatim i tillë do të konsiderohet sikur të jetë paguar.

NENI 25

MOS-DISKRIMINIMI

1. Nënështetasit e një Shteti Kontraktues nuk do t'i nënështrohen në Shtetin tjetër Kontraktues ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të që të jetë i ndryshëm ose me i rëndë se sa tatimi dhe kërkesa të lidhura me të, të cilave i nënështrohen ose mund t'i nënështrohen nënështetasit e këtij Shteti tjetër në rrethana të njëjta. Kjo dispozitë, pamvarësisht nga dispozitat e Nenit 1, do të zbatohet gjithashtu ndaj personave që nuk janë rezidentë të njërit apo asnjërit prej Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi i një selie të përherëshme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë Shtet tjetër se sa tatimi i vjelur ndaj sipërmarrjeve të këtij Shteti tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të merret si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'i garantuar rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues përjashtime, lehtësime personale apo reduktime tatimore që i garanton rezidentëve të Shtetit të vet për gjendjen civile dhe përgjegjësitë familiare që ata kanë.

3. Përjashtuar rastet kur zbatohen dispozitat e Nenit 9, paragrafit 7 të Nenit 11, ose paragrafit 6 të Nenit 12, interesat, honoraret dhe shpërblime të tjera të paguara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj sipërmarrje, do të jenë të reduktueshme nën

të njëjtat kondita njëlloj sikur ato t'i paguheshin një rezidenti të Shtetit të përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, borxhet e kontraktuara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues me rezidenë të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj sipërmarrje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kondita njëlloj siç do të reduktoheshin sikur të ishin kontraktuar me një rezident të Shtetit të përmendur në fillim.

4. Sipërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është totalisht ose pjesërisht i zotëruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt, nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do t'i nënështrohen në Shtetin Kontraktues të përmendur në fillim ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të që të jetë i ndryshëm ose me i rëndë se sa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënështrohen ose mund t'i nënështrohen sipërmarrje të tjera të ngjashme të Shtetit të përmendur në fillim.

5. Dispozitat e këtij Neni, pamvarësisht nga dispozitat e Nenit 2, do të zbatohen ndaj tatimeve të çdo lloji.

NENI 26

PROÇEDURA E MIREKUPTIMIT RECIPROK

1. Kur një rezident i një Shteti Kontraktues mendon se veprimet e njërit apo e të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë apo do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, ai mundet, pamvarësisht nga mënyrat e ankimit të parashikuara në legjisllacionin e brendshëm të këtyre Shteteve, t'ja paraqesë rastin e tij autoriteteve kompetente të Shtetit Kontraktues rezident i të cilit ai është ose, nëse rasti i tij lidhet me paragrafin 1 të Nenit 25, autoriteteve kompetente të Shtetit Kontraktues nënështetas i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda dy viteve nga njoftimi i parë lidhur me veprimin që ka rezultuar në tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhje të kënaqshme, do të përpiqet t'a zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangjen e tatimit që nuk është në përputhje me Konventën.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktues do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim reciprok çdo vështirësi apo dyshim që lind nga interpretimi apo zbatimi i Konventes.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri tjetrin direkt për arritjen e mirëkuptimit në kuptimin e paragrafëve të mësipërm. Kur shihet e arsyeshme që për arritjen e mirëkuptimit të zhvillohen shkëmbime direkte

të opinioneve, ato mund të bëhen nëpërmjet një komisioni të përbërë nga përfaqësues të autoriteteve kompetente të Shteteve Kontraktuese.

NENI 27

SHKEMBIMI I INFORMACIONIT

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktues do të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente ose të ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese lidhur me tatimet që mbulon kjo Konventë përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me Konventën si edhe për parandalimin e evazionit fiskal. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga Neni 1. Çdo informacion i marrë nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij Shteti dhe do t'i serviret vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në llogaritjen apo mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore apo lidhur me ankesat ndaj tatimeve që mbulon Konventa. Këto persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime. Ato mund ta servirin informacionin në procedurat apo vendimet gjygjësore.

2. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Shteteve Kontraktues detyrimin:

- (a) të zbatojë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikat administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;
- (b) të japë informacione që ndalohen sipas ligjeve apo praktikës normale administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;
- (c) të japë informacione që mund të nxirrnin një sekret tregtar, industrial apo profesional apo proces tregtar ose informacione, zbulimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me rendin publik.

NENI 28

FUNKSIONARET DIPLOMATIKE DHE KONSULLLORE

Dispozitat e kësaj Konvente nuk çenojnë privilegjet fiskale të funksionarëve diplomatikë dhe zyrtarëve konsullorë që rrjedhin nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombetare apo nga dispozita të marrëveshjeve të vecanta.

NENI 29

RIMBURSIMET

1. Tatimet e vjelura në burim në një Shtet Kontraktues do të rikthehen (riimbursohen) me kërkesë të tatimpaguesit ose të Shtetit rezident i të cilit ai është nëse e drejta për të mbledhur tatimet në fjalë ka lindur nga dispozitat e kësaj Konvente.

2. Kërkesat për rimbursim, që duhet të bëhen brenda kohës të përcaktuar nga legjislacioni i Shtetit Kontraktues që është i detyruar të bëjë rimbursimin, do të shoqërohen nga një çertifikatë zyrtare nga Shteti Kontraktues rezident i të cilit është tatimpaguesi duke vërtëtuar egzistencën e kushteve të kërkuara për të gëzuar të drejtën e kërimit të rimbursimit që rrjedh nga kjo Konventë.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese me mirëkuptim reciprok do të vendosin mënyrën e aplikimit të këtij Neni, në përputhje me dispozitat e Nenit 26 të kësaj Konvente.

NENI 30

HYRJA NE FUQI

1. Kjo Konventë do të ratifikohet dhe instrumentat e ratifikimit do të shkëmbehen në sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Konventa do të hyjë në fuqi me shkëmbimin e instrumentave të ratifikimit dhe dispozitat e saj do të kenë efekt lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar më ose pas ditës së parë të Janarit të vitit kalendarik që pason atë të hyrjes në fuqi të Konventës. Për qëllimet e Nenit 27 (Shkëmbimi i informacionit), dispozitat e tij do të kenë efekt më dhe pas datës në të cilën Konventa hyn në fuqi.

NENI 31

PERFUNDIMI

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi deri në përfundimin nga njëri Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të përfundojë Konventën pas 5 vjetësh pas vitit të hyrjes në fuqi duke dhënë njoftimin e përfundimit nëpërmjet kanaleve diplomatike, të paktën 6 muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik. Në rast të tillë Konventa do të pushojë së pasuri efekt lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar më ose pas ditës së parë të Janarit që pason atë të dhënjes së njoftimit të

përfundimit.

Në praninë dhe të autorizuar në mënyrën e duhur, nënshkruesit kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Tiranë, më 12 Dhjetor, 1994, në dy kopjo në gjuhën Shqipe, Italiane dhe Angleze, të trija tekstet me fuqi ligjore të barabartë, përveç në raste dyshimesh, në të cilat teksti në gjuhën Angleze do të ketë përparësi.

PER QEVERINE E

REPUBLIKES SE ITALISE

PER QEVERINE E

REPUBLIKES SE SHQIPERISE

PROTOKOLL SHITESË

I Konventës midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për shmangjen e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe parandalimin e evazionit fiskal.

Në nënshkrimin e Konventës së përfunduar sot midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për shmangjen e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal nënshkruesit kanë rënë dakord për dispozitat shtesë në vijim të cilat do të përbëjnë një pjesë integrale të Konventës në fjalë.

Eshtë e kuptueshme se:

1. Referuar paragrafit 1 të Nenit 3, termat "vend i drejtimit efektiv" do të përfshijnë, në veçanti, objektin kryesor të aktiviteteve të sipërmarrjes.

2. Referuar paragrafit 3 të Nenit 7, termat "shpenzime të kryera për qëllimet e selisë së përherëshme" nënkuptojnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me aktivitetin e selisë së përherëshme.

3. Referuar Nenit 8 një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues që realizon fitime nga veprimtaria e anijeve, avjonëve ose mjeteve të transportit rrugor në trafikun ndërkombëtar nuk do të jetë subjekt i tatimeve lokale mbi të ardhurat që vilen në Shtetin tjetër Kontraktues.

4. Nëqoftëse, në përputhje me Nenin 9, nga njëri Shtet Kontraktues lidhur me një person është bërë një ripërcaktim (rregullim) i tatimit, Shteti tjetër Kontraktues, kur është dakort se ky ripërcaktim reflekton rregullime ose kondita që do të bëheshin apo vendoseshin midis personave të pavarur, do të bëjë rregullimet e duhura lidhur me personat që lidhen me personin e përmendur në fillim dhe që janë subjekt i juridiksionit tatimor të atij Shteti. Çdo rregullim i tillë do të bëhet vetëm në përputhje me procedurën e mirëkuptimit reciprok e dhënë në Nenin 26 dhe me paragrafin 7 të këtij Protokolli Shtesë.

5. Referuar paragrafëve 1 dhe 2 të Nenit 19, shpërblimet e paguara një individi lidhur me shërbimet e kryera Institutit Italian të Tregtisë së jashtme (I.C.E.) dhe Institutit Italian të Kulturës (Istituto Italiano di Cultura) si edhe institucioneve korresponduese Shqiptare, do të mbulohen nga dispozitat lidhur me funksionet qeverirare.

6. Referuar Nenit 23, nëse një tatim mbi kapitalin do të

paraqitet në një Shtet Kontraktues, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të bien dakort për dispozitat specifike që do të përfshihen në atë Nen, në përputhje me parimet që përmban i ai Nen. Ato do të kompletojnë gjithashtu listën e tatimeve të dhëna në paragrafin 3 të Nenit 2 të kësaj Konvente.

7. Lidhur me Nenin 26, një rregullim i tatimeve në përputhje me atë Nen mund të bëhet vetëm me përcaktimin përfundimtar të këtyre tatimeve. Është e kuptueshme se, në rastin e Italisë, fjalija e mëparëshme nënkupton që kërkimi i procedurës së mirëkuptimit reciprok nuk e lehtëson tatimpaguesin nga detyrimi për të filluar procedurat e legjislacionit të brendshëm për zgjidhjen e konflikteve tatimore.

8. Dispozitat e paragrafit 3 të Nenit 29 nuk do të pengojnë autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese nga zbatimi, me mirëkuptim reciprok, i praktikave të tjera për lejimin e reduktimeve për qëllimet tatimore të dhëna nga kjo Konventë.

Në prani të dëshmitarëve nënshkruesit, të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Protokoll Shtesë.

Bërë në dy kopjo në Tiranë, më 12 Dhjetor 1994, në gjuhën Shqipe, Italiane dhe Angleze, të gjitha tekstet janë me fuqi të barabartë, përveç në raste dyshimesh në të cilat raste teksti në gjuhën Angleze do të ketë përparësi.

PER QEVERINË E
REPUBLIKES SE SHQIPERISE

PER QEVERINE E
REPUBLIKES SE ITALISE